




Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË
SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PËRMBLEDHJA E DETYRAVE NGA
MATEMATIKA

PËR PROVIMIN E FUNDIT NË ARSIMIN DHE EDUKIMIN FILLOR PËR VITIN SHKOLLOR 2010/2011.





Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT

ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË
SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PËRMBLEDHJE E DETYRAVE NGA

MATEMATIKA

PËR PROVIMIN E FUNDIT NË ARSIMIN DHE EDUKIMIN FILLOR
PËR VITIN SHKOLLOR 2010/2011

Autorë

Spec. Aleksandra Rosiq, SHF Miroslav Antiq’.

Jagoda Rançiq, SHF “Kosta Abrasheviq”

Jovan Gjukoviq, SHF “20 Tetor”

mr. Milan Knezheviq, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe i Matematikës në Beograd,
Gjimnazi Matematikor

Mira Stojisavleviq Radovanoviq, SHF “Borisllav Pekiq”

Petar Ogrizoviq, SHF “Rugjer Boshkoviq”

Ruzhica Bogdanoviq, Gjimnazi i parë i Beogradit

Beograd, 2011

**PËRMBLEDHJE E DETYRAVE NGA MATEMATIKA
PËR PROVIMIN E FUNDIT NË ARSIMIN DHE EDUKIMIN FILLOR PËR VITIN
SHKOLLOR 2010/2011**

Botues

Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë
Enti për Vlerësimin e Cilësisë së Arsimit dhe të Edukimit

Për botuesin

Dr. Zharko Obradović, ministër i Arsimit
Mr. Dragan Banićević, drejtor i Entit për Vlerësimin e Cilësisë së Arsimit dhe të Edukimit

Redaktore

Dragana Stanojević, këshilltare-koordinatore për matematikë në Entin për Vlerësimin e Cilësisë së Arsimit dhe të Edukimit Fillor

Recensentë

Dr. Branko Popović, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe i Matematikës, Kragujevac
Dr. Zorana Luzhanin, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe i Matematikës, Novi Sad

Këshilltare profesionale

Dr. Dragica Pavlović Babić, Instituti për Psikologji, Beograd
Dr. Dijana Plut, Instituti për Psikologji, Beograd

Përkthyes

Naile Mala Imami

Hartimi i përmbledhjes me detyra është financuar nga buxheti i Republikës së Serbisë, përmes Projektit 2601-08 IPA 2008 *Përkrahja për sigurimin e cilësisë së provimeve të fundit në nivel kombëtar në arsimin fillor dhe të mesëm.*

Të dashur nxënës, të dashura nxënëse

Para vetes e keni përmbledhjen me detyra nga matematika. Përmbledhja është përgatitur për të ushtruar dhe për t'u përgatitur për dhënien e provimit të fundit. Detyrat në përmbledhje janë klasifikuar, sipas ndërlikueshmërisë së kërkesave, në nivel bazë, të mesëm dhe të përparuar. Në kuadër të secilit nivel, detyrat janë klasifikuar në këto fusha: Numrat dhe veprimet me ta, Algjebra dhe funksionet, Gjeometria, Matja dhe Përpunimi i të dhënave.

Në përmbledhje gjenden edhe detyrat të cilat do të jenë në provimin e fundit, plotësisht të njëjta ose pjesërisht të ndryshuara. Në test, përveç detyrave nga përmbledhja, do të gjenden edhe detyrat e reja. Për t'u përgatitur edhe për këtë pjesë të provimit, në përmbledhje janë dhënë shembujt e detyrave të tilla.

Në pjesën e fundit të përmbledhjes së detyrave janë dhënë zgjidhjet, si edhe lista e standardeve për arsim të cilat anketohen me detyrat nga përmbledhja. Zgjidhjet e detyrave nuk i përmbajnë procedurat, por vetëm rezultatet, si do të mund t'i zgjidhni detyrat në mënyra të ndryshme.

Testet të cilat do t'i zgjidhni në provimin e fundit i përmbajnë detyrat me të cilat anketohet realizimi i standardeve për arsim me të tri nivelet, bazë, të mesëm dhe të përparuar. Në test secila detyrë vlerësohet me një pikë në provimin e fundit.

Ju dëshirojmë punë të mbarë dhe të suksesshme!

Autorët

Përmbajtja

NIVELI BAZË	7
Numrat dhe veprimet me ta	7
Algjebra dhe funksionet	15
Gjeometria	19
Matjet	27
Përpunimi i të dhënave	32
NIVELI I MESËM	40
Numrat dhe veprimet me ta	40
Algjebra dhe funksionet	44
Gjeometria	49
Matjet	55
Përpunimi i të dhënave	58
NIVELI I PËRPARUAR	63
Numrat dhe veprimet me ta	63
Algjebra dhe funksionet	65
Gjeometria	68
Matjet	75
Përpunimi i të dhënave	77
Shembujt për pjesën e testit në provimin e fundit të cilat do t'i anketojnë detyrat e reja të pabotuara	85
Zgjidhjet	89
Lista e standardeve për arsim të cilat anketohen me detyrat në provimin e fundit	105
Pohimet vijuese e përshkruajnë çfarë di nxënësi/nxënësja	105

NIVELI BAZË

Numrat dhe veprimet me ta


1. Një sekretareshë në ndërmarrjen “Eksport” duhet të shkruajë me shkronja shumën në dinarë. Si do ta shkruajë me shkronja këtë shumë?

FATURA	
Gjithsej për pagesë:	<input type="text" value="200 012,00"/> dinarë
Me shkronja:	_____

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) njëzet mijë dymbëdhjetë dinarë
- b) dy mijë dymbëdhjetë dinarë
- c) dyqind mijë dymbëdhjetë dinarë
- d) dy milionë dymbëdhjetë dinarë


2. Lidhi sipas shembullit të dhënë.




3. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.
Dy të plota dhe shtatëmbëdhjetë të njëmijëta
- a) 2,17
 - b) 2,017
 - c) 2,170
 - d) 2,0017

4. Një shteg alpinizmi është i gjatë dy mijë e dhjetë metra. Si e shënon me shifra gjatësinë e tij?
Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.
- a) 200 010 m
 - b) 20 010 m
 - c) 2 010 m
 - d) 2 100 m

5. Lidhi me vija numrat e njëjtë sipas shembullit të dhënë:



6. Lidh secilin numër dhjetor me thyesën përkatëse.



7. Numrin e dhënë shënoje në shënimin dhjetor.

a) $\frac{1}{2} =$

b) $\frac{3}{4} =$

c) $\frac{1}{5} =$

d) $\frac{1}{8} =$

e) $\frac{4}{10} =$

8. Numrin e dhënë shënoje në shënimin dhjetor.

a) njëmbëdhjetë të dhjetat _____

b) tri gjysma _____

c) një e njëqinda _____

9. Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

Numri 0,75 është i barabartë me thyesën.

a) $\frac{1}{4}$

b) $\frac{100}{75}$

c) $\frac{3}{4}$

d) $\frac{75}{10}$

10. Cili nga numrat e ofruar është i barabartë me numrin 0,3?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

a) $\frac{10}{3}$

b) $\frac{3}{10}$

c) $\frac{1}{3}$

d) $\frac{3}{1}$

11. Në cilin qytet është shënuar temperatura e ajrit më e afërt me zeron?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) Vranjë -2°C
- b) Beograd -8°C
- c) Suboticë -12°C
- d) Nish -5°C

12. Në video lojën „Decimal“ fiton lojtari i cili e ka fituar numrin më të madh të pikave.

Lojtarët e kanë fituar këtë numër të pikave:

Merita	125,32 pikë
Ema	152,28 pikë
Skënderi	152,18 pikë
Arta	125,03 pikë

Cili nga lojtarët e ka fituar vendin e tretë?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) Merita
- b) Ema
- c) Skënderi
- d) Arta

13. Për secilin pohim rretho përgjigjen I SAKTË, e nëse mosbarazimi është i saktë, ose I PASAKTË nëse mosbarazimi nuk është i saktë.

$$\frac{1}{2} < \frac{2}{3}$$

I SAKTË

I PASAKTË

$$\frac{2}{3} > 1$$

I SAKTË

I PASAKTË

$$\frac{11}{5} < 2$$

I SAKTË

I PASAKTË

$$-4 < -2$$

I SAKTË

I PASAKTË

14. Rretho shkronjën para rendit në të cilin janë radhitur numrat nga më i vogli deri te më i madhi.

a) $-\frac{4}{9}, -\frac{5}{9}, \frac{1}{9}, \frac{2}{9}$

b) $-\frac{5}{9}, -\frac{4}{9}, \frac{1}{9}, \frac{2}{9}$

c) $-\frac{5}{9}, -\frac{4}{9}, \frac{2}{9}, \frac{1}{9}$

d) $\frac{1}{9}, \frac{2}{9}, -\frac{4}{9}, -\frac{5}{9}$

15. Janë dhënë numrat

a) Më i vogli nga këta numra është

b) Më i madhi nga këta numra është

16. Llogarit ndryshimin e numrave 132,5 dhe 89,32.

17. Bashko secilën shprehje me vlerën përkatëse.

$$\frac{3}{7} + \frac{2}{7} \cdot$$

$$\cdot \frac{6}{7}$$

$$\frac{5}{9} - \frac{3}{9} \cdot$$

$$\cdot \frac{3}{7}$$

$$6 \cdot \frac{1}{7} \cdot$$

$$\cdot \frac{5}{7}$$

$$\frac{6}{7} : 2 \cdot$$

$$\cdot \frac{2}{9}$$

18. Llogarit dhe shkruaj rezultatin përkatës.

a) $1,08 + 2,33 =$

b) $1,08 - 2,33 =$

c) $0,6 \cdot 3,2 =$

d) $2,4 : 6 =$

19. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Një e pesta e numrit 150 është e barabartë me

a) 3

b) 15

c) 30

d) 50

20. Llogarit dhe shkruaj rezultatin përkatës.

a) $-6 : 2 =$

b) $-6 - 2 =$

c) $-6 \cdot 2 =$

d) $-6 + 2 =$

21. Rretho PO nëse pohimi është i saktë, ose JO nëse është i pasaktë.

Numri 153 është i pjesëtueshëm me numrin 2. PO JO

Numri 186 është i pjesëtueshëm me numrin 3. PO JO

Numri 2018 është i pjesëtueshëm me numrin 4. PO JO

Numri 10025 është i pjesëtueshëm me numrin 25. PO JO

22. Cila mbetje fitohet kur numri 519 pjesëtohet me numrin 9?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

a) 6

b) 7

c) 8

d) 9

23. Cili prej numrave të dhënë është i pjesëtueshëm me 5?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

a) 7870

b) 5872

c) 5551

d) 2533

24. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Mbetja me rastin e pjesëtimit të numrit 2355 me numrin 7 është

- a) 0
- b) 1
- c) 3
- d) 5

25. Plotëso tabelën e mëposhtme sipas shembullit të dhënë.

I pjesëtueshmi	pjesëtuesi	mbetja
21376	10	6
123	2	
237	3	
128	5	

26. Llogarit.

- a) $(9 - 9) : 3 =$
- b) $3 \cdot (6 + 4) =$
- c) $(6 \cdot 3) + (5 \cdot 3) =$
- d) $100 : (50 : 2) =$

27. Sa është vlera e shprehjes $4 \cdot (-5) + 10$?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.


- a) 30
- b) -10
- c) -20
- d) -30

28. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Vlera e shprehjes $-1 + 2 - 3 + 4 - 5 + 6 - 7 + 8$ është e barabartë me

- a) -36
- b) -4
- c) 0
- d) 4
- e) 36

29. Në secilën fushë të zbrazët shkruaj numrin përkatës.



30. Sot e ka ditëlindjen Shqipja dhe ajo për tri vjet do të mbushë 18 vjet. Sa vjet i ka sot Shqipja?
Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 12
- b) 15
- c) 18
- d) 21

Algjebra dhe funksionet

31. Secilin barazim lidhe me barazimin ekuivalent.

$$\frac{1}{2}x = 8 \cdot$$

• $x = 1$

$$x + \frac{3}{4} = \frac{7}{4} \cdot$$

• $x = 3$

$$x - \frac{3}{2} = \frac{9}{2} \cdot$$

• $x = 6$

$$x : \frac{1}{2} = 14 \cdot$$

• $x = 7$

• $x = 16$

32. Zgjidh barazimin.

a) $2(x + 3) = 0$

b) $24 \cdot x = 6$

33. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Numri 5 është zgjidhja e barazimit:

a) $5x = 0$

b) $x + 5 = 0$

c) $\frac{1}{5}x + 2 = 3$

d) $2(x - 5) = 2$

34. Zgjidh barazimin.

$$-2,5 - x = 1,5$$

35. Cili numër është zgjidhja e barazimit $\frac{x}{2} + 2 = 8$?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

a) 5

b) 6

c) 12

d) 20

36. Llogarit vlerën e shprehjes.

$$-2 \cdot (-2)^2 + 2^3 - (-2)^3 =$$

37. Lidhi sipas shembullit të dhënë.

$$2^3 \cdot 2^2 \bullet \bullet 7^5$$

$$5^{13} : 5^2 \bullet \bullet 2^5$$

$$(7^2)^3 \bullet \bullet 5^{11}$$

$$5^3 \cdot 5^{12} \bullet \bullet 7^6$$

$$7^8 : 7^3 \bullet \bullet 5^{15}$$

38. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Shprehjes x^5 i përgjigjet shprehja:

- a) $x + x + x + x + x$
- b) $x + 5$
- c) $x^2 + x^3$
- d) $x \cdot x \cdot x \cdot x \cdot x$

39. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Prodhimi $2^{10} \cdot 2^2$ është i barabartë me:

- a) 2^5
- b) 2^8
- c) 2^{12}
- d) 2^{20}

40. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Vlera e fuqisë $0,3^2$ është:

- a) 0,06
- b) 0,6
- c) 0,09
- d) 0,9

41. Nëse $A = -2a^2$ dhe $B = 5a^2$ llogarit: $A + B$, $A - B$, $A \cdot B$.

42. Thjeshtëso shprehjen.

a) $17 - 2x + 13 + 5x$

b) $2x^2 - 2x \cdot 5x$

43. Rretho PO nëse barazimi është i saktë ose JO nëse barazimi nuk është i saktë.

$-5a - (-7a) = -12a$	PO	JO
$7a \cdot (-5a) = -35a$	PO	JO
$5a \cdot (-7a) = -35a^2$	PO	JO
$-5a + (-7a) = -12a$	PO	JO

44. Thjeshtëso shprehjen.

a) $2a \cdot 7b$

b) $3x^2 \cdot 5x^3$

c) $-0,25 \cdot m^2 \cdot 8n$

d) $(-\frac{1}{3}x) \cdot (-\frac{9}{2}y)$

45. Rregullo këtë shprehje:

a) $5a^3 + 7a^3 =$

b) $9x^2 - 4x^2 =$

c) $2b \cdot 3b^2 =$

46. Është dhënë funksioni $y = 10x - 5$.

Plotëso tabelën me vlerat përkatëse për x dhe y .

x	0	$\frac{1}{2}$		5
y			5	

47. Është dhënë funksioni $y = \frac{1}{3}x + 2$. Cakto vlerën e funksionit për $x = -3$.

Vlera e funksionit të dhënë për $x = -3$ është $y = \underline{\hspace{2cm}}$.

48. Për cilin x është vlera e funksionit $y = -x + 4$ e barabartë me zero?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 8
- b) 6
- c) 4
- d) 2

49. Plotëso tabelën me vlerat përkatëse.


x	0	-2	4	0,5
$y = -\frac{1}{2}x + 2$				

50. Funksioni është dhënë me formulë $y = 2x + 1$. Llogarit vlerat përkatëse të ndryshoreve x dhe y dhe plotëso tabelën.

x	0		4
y		5	

Gjeometria

51. Në fotografi janë dhënë objektet gjeometrike.




Në vijë shkruaj numrin i cili u përgjigjet objekteve gjeometrike në fotografi.

- a) drejtëza _____
- b) gjysmëdrejtëza _____
- c) segmenti _____
- d) këndi _____

52. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Kënde të ngushta janë:

- a) α dhe β
- b) α dhe γ
- c) β dhe δ
- d) β dhe φ



53. Në vijë shkruaj numrin ashtu që të fitosh pohimin e saktë.

Drejtëzat janë paralele në figurën ____, drejtëzat janë normale në figurën ____




Figura 1




Figura 2




Figura 3





Figura 4





54. Erlinda e ka vizatuar në fletore trekëndëshin ABC . Vetëm njëra nga fjalitë e mëposhtme, që ka të bëjë me këndet e këtij trekëndëshi, është e saktë.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.


- a) Trekëndëshi ABC i ka dy këndet të gjera dhe një kënd të ngushtë.
- b) Trekëndëshi ABC e ka një kënd të drejtë dhe dy kënde të ngushta
- c) Të gjitha këndet e trekëndëshit ABC janë të ngushta.
- d) Një kënd i trekëndëshit ABC është i gjerë, dy kënde janë të ngushta
- e) Trekëndëshi ABC nuk ka asnjë kënd të ngushtë.



55. Lidh fotografinë me emërtimin e figurës të cilën ajo fotografi e paraqet.

	•	• segmenti
	•	• këndi
	•	• gjysmëdrejtëza
	•	• drejtëza

56. Në secilin rresht rretho fjalën përkatëse për trekëndëshin e dhënë ABC .




Lloji i trekëndëshave sipas këndeve	këndngushtë	kënddrejtë	këndgjerë
Lloji i trekëndëshave sipas brinjëve	barabrinjës	brinjëndryshëm	barakrahës

57. Udhëtari ka ecur nga vendi A në veri 12 km dhe ka arritur në vendin C , e pastaj ka ecur në drejtim të lindjes 5 km dhe ka arritur në vendin B .

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Largësia më e shkurtër midis vendit A dhe B është:


- a) 13 km
- b) 17 km
- c) 30 km
- d) 60 km



58. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Sipërfaqja e trekëndëshit në fotografi është:

- a) $9,2 \text{ cm}^2$
- b) $18,4 \text{ cm}^2$
- c) 42 cm^2
- d) 84 cm^2




59. Cilën sipërfaqe të dyshemesë e mbulon qilimi me formë të drejtkëndëshit me gjatësi 3,5 dhe gjerësi 2 m?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 11 m^2
- b) 7 m^2
- c) $5,5 \text{ m}^2$
- d) 3,5 m

60. Llogarit gjatësinë e hipotenuzës së trekëndëshit kënddrejtë të vizatuar në fotografi.



Gjatësia e hipotenuzës është _____ cm

61. Sa është sipërfaqja e rrethit të rrezes 9 cm?


Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 18 cm^2
- b) $18\pi \text{ cm}^2$
- c) 81 cm^2
- d) $81\pi \text{ cm}^2$

62. Një segment është diametër i rrethit në fotografi. Cili është ai segment?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.


- a) AB
- b) AC
- c) AD
- d) AE




63. Në një fotografi është segmenti AB korda e rrethit. Cila është ajo fotografi?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.


a)




b)



c)



d)



64. Shenja rrugore në fotografi ka formë rrethore, dhe e tregon pjesën e rrugës në të cilën është e ndaluar lëvizja e këmbësorit..

Sa është sipërfaqja e kësaj shenje rrugore nëse rrezja e saj është 30 cm?

Sipërfaqja e shenjës rrugore është _____ cm^2 .



65. Sa është perimetri i rrethit rrezja e të cilit është 7 cm?


Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 14 cm
- b) 49 cm
- c) 14π cm
- d) 49π cm

66. Cilën figurë e paraqet brinja e ngjyrosur e kubit?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) katrori
- b) drejtkëndëshi
- c) rombi
- d) trapezi




67. Pishina është e gjatë 12 m, e gjerë 5 m, e thellë 2 m. Sa metra kub të ujit më së shumti mund të ketë në atë pishinë.

Në pishinë mund të ketë më së shumti _____ metra kub të ujit.

68. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Sipërfaqja e kuboidit në fotografi është:


- a) $11,5 \text{ cm}^2$
- b) $42,5 \text{ cm}^2$
- c) 50 cm^2
- d) 85 cm^2



69. Shpendi në orën e arsimit teknik e ka bërë kutinë prej kartoni në formë të kubit brinja e të cilit është 5 cm. Sa është sipërfaqja e kutisë së Shpendit?


Sipërfaqja e kutisë së Shpendit është ____ cm^2 .

70. Tehu i bazës së prizmit të rregullt katërfaqësh është 6 cm, kurse lartësia e prizmit është 10 cm. Sa është sipërfaqja e prizmit të dhënë?




Sipërfaqja e prizmit është _____ cm^2 .

71. Rretho PO nëse është pohimi i saktë ose JO nëse pohimi nuk është i saktë.



Diametri i sferës është 2 cm.	PO	JO
Gjatësia e përftores së konit është 5 cm.	PO	JO
Rrezja e bazës së cilindrit është 2 cm.	PO	JO
Lartësia e konit është 4 cm.	PO	JO

72. Me cilët numra është shënuar cilindri?




Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 2 dhe 4
- b) 3 dhe 4
- c) 1 dhe 5
- d) 2 dhe 5

73. Mbështjellësi i konit është i shtrirë në rrafsh. Nga figurat e dhëna cila e paraqet këtë mbështjellës?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.




74. Në fotografi janë objektet forma e të cilave ngjan në cilindër, kon dhe sferë.

Nën secilën fotografi shkruaj emërtimin e formës përkatëse.




75. Në secilën fotografi e cila e paraqet cilindrin shkruaj numrin 1, në secilën fotografi e cila e paraqet konin shkruaj numrin 2, në secilën fotografi e cila e paraqet sferën shkruaj numrin 3.




76. Në njërin prej vizatimeve janë figurat e shënuara me numrat 1 dhe 2 që përgjigjen (përkojnë). Në cilin vizatim janë këto figura të cilat përgjigjen.


Rretho shkronjën nën përgjigjen e saktë.




a)



b)



c)




d)





77. Rretho PO nëse figurat A dhe B në fotografi janë përgjegjëse ose JO nëse nuk janë përgjegjëse.

PO	JO	PO	JO	PO	JO	PO	JO



78. Lidh figurat të cilat janë përgjegjëse njëra me tjetrën.



79. Cila figurë në fotografi është përgjegjëse me figurën A?
Rretho shkronjën mbi përgjigjen e saktë.



80. Është dhënë figura F. Ngjyros atë që është e nevojshme që figura në fotografinë e mëposhtme të jetë përgjegjëse me figurën F.



Matjet

- 81.** Plotëso vendet e zbrazëta me këto njësi matëse: cm^2 , kg, h, $^\circ$, l, m, kështu që fjalitë të jenë të sakta.
Alpinisti, Artani është nisur të ngjitet në Majen e Pançiqit (lartësia 2017___). E ka marrë çantën e shpinës të rëndë 12___. Në çantë e ka: flamurin me sipërfaqe 1500___, disa shishe me ujë me vëllim 0,75___ dhe me pajisjen e cila i ndihmon që të ngjitet edhe pse ngjitja është më e madhe se 25___. Artani planifikon që pauzën e parë ta bëjë pas 3 ___ ecjeje.

- 82.** Arta jeton përballë shkollës. Sa është shtëpia e saj larg nga shkolla?


Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 119 mm
- b) 31 cm
- c) 15 m
- d) 2 km

- 83.** Kaltrina saktësisht e ka matur këndin α në fotografi. Si duhet ta shkruajë Kaltrina rezultatin e matjes së vet?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 110 cm
- b) 110'
- c) 110 $^\circ$
- d) 110 mm
- e) 110''



- 84.** Cilën njësi matëse e përdor për matjen përkatëse?


Lidhi sipas shembullit të dhënë.

kohëzgjatja e pushimit në shkollë •	• minutë
largësia midis Somborit dhe Vranjës •	• gradë
vëllimi i lëngut në shishen e ujit •	• m^2
masa e njeriut •	• cm^3
gjatësia e fletores •	• kilometër
sipërfaqja e dhomës •	• centimetër
këndi midis akrepave të orës dhe minutave në orë •	• kilogram


85. Fushën e ndryshme në tabelë plotësoje me njësinë përkatëse matëse.

	Numri matës	Njësia matëse
Sipërfaqja e një klase	50	
Largësia midis Beogradit dhe Nishit	220	
Masa e një molle	120	
Kohëzgjatja udhëtimi me aeroplan nga Beogradi deri në Athinë.	2	

86. Lidhi sipas shembullit të dhënë.




87. Lidhi sipas shembullit të dhënë.



88. Shkruaj numrin i cili mungon ashtu që të fitosh barazimin e saktë.

- 3 km = ____ m
- 20 m = ____ cm
- 4,5 t = ____ kg
- 4 javë = ____ ditë

89. Cakto në gramë masën e objektit A në fotografi.



Masa e objektit A është _____ g.

90. Cila periudhë kohore është më e gjatë?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) tre muaj
- b) 100 ditë
- c) 10 javë
- d) një e katërta e vitit

91. Merita e ka marrë me vete në dyqan një bankënotë prej 1.000 dinarësh dhe i ka harxhuar 300 dinarë. Shitësi ia ka kthyer kusurin duke e përdorur numrin më të vogël të bankënotave. Sa bankënota i ka marrë Merita.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 1 bankënotë
- b) 2 bankënota
- c) 3 bankënota
- d) 4 bankënota

92. Pikniku njëditor prej Beogradi deri në Paliq kushton 4 850 dinarë. Me cilat bankënota mund ta paguash piknikun?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 48 bankënota prej 100 dinarësh
- b) 24 bankënota prej 200 dinarësh
- c) 9 bankënota prej 500 dinarësh
- d) 97 bankënota prej 50 dinarësh

93. Mentori i ka 6 bankënota prej nga 50 dinarë dhe 7 bankënota prej nga 20 dinarë. Ai dëshiron të paguajë mbushjen për celular prej 500 dinarësh për të fituar bonusin. Edhe sa të holla duhet të kursejë për të blerë mbushjen?

Mentori duhet të kursejë _____ dinarë.

- 94.** Orgesi i ka pasur në kuletë bankënotat e dhëna në fotografi. Në librari e ka blerë një laps për 22 dinarë, gomën për 17 dinarë dhe librin për 90 dinarë.

Sa të holla i kanë mbetur Orgesit?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 1 dinar
- b) 6 dinarë
- c) 11 dinarë
- d) 16 dinarë



- 95.** Nëse i këmben 3 bankënota prej nga 200 dinarë me bankënota prej 50 dinarësh, sa bankënota do të fitosh?

Do të fitoj _____ bankënota me nga 50 dinarë.

- 96.** Gjyshja ka planifikuar të blejë një thes specia me masën 25 kg. Shitësi ia ka ofruar katër thasë me masë prej 25,62 kg, 24,92 kg, 24,40 kg dhe 25,83 kg. Cilin thes duhet ta zgjedhë gjyshja që masa e tij të dallohet më së paku prej 25 kg?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 24,40 kg
- b) 24,92 kg
- c) 25,62 kg
- d) 25,83 kg

- 97.** Dritani është i gjatë 147 cm. Katër shokë në kontroll sistematik e kanë matur gjatësinë e tij. Vetoni e ka matur 1 m e 40 cm, Arti e ka matur 1 m e 45 cm, Roni e ka matur 1 m e 40 cm dhe Rigoni 1 m e 55 cm. Cili shok e ka bërë gabimin më të vogël gjatë matjes.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) Vetoni
- b) Arti
- c) Roni
- d) Rigoni

- 98.** Cili nga numrat e dhënë është më i afërt me numrin 12,452?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 12,40
- b) 12,45
- c) 12,46
- d) 12,50

99. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Largësia midis Beogradit, kryeqytetit të Serbisë, dhe Londrës, kryeqytetit të Mbretërisë së Bashkuar, është 1688,97 km. Kjo përafërsisht është:

- a) 1 500 km
- b) 1 600 km
- c) 1 700 km
- d) 1 800 km




100. Në fushën e zbrazët shkruaj njësinë matëse përkatëse: km, cm, l, kg ose g.

	Numri matës	Njësia matëse
Sasia e benzinës në rezervoarin e automobilit	50	
Largësia midis Beogradit dhe Krushevcit	200	
Masa e një dardhe	120	
Diametri i topit të tenisit	8	
Masa e një qeni	12	

Përpunimi i të dhënave


101. Në sistemin e dhënë koordinativ shëno pikat përkatëse:

- A (3, 1)
- B (5, 2)
- C (1, 3)
- D (2, 5)
- E (1, 2)
- F (4, 5)
- G (5, 3)




102. Në vizatim është dhënë pozita e bankave në klasë. Rreshtat numërohen nga e majta në të djathtë, kurse bankat duke u nisur nga tabela. Shëno vendin ku është ulur Artani, nëse ai ulet në rreshtin e parë, në bankën e katërt, nga ana e djathtë.

MAJTAS TABELA DJATHTAS




103. Drita e mban majen e lapsit në pozicionin e fillimit koordinativ (pika O). Pastaj lëvizen 7 njësi matëse djathtas dhe 9 njësi matëse vertikalisht së larti dhe kështu arrin në pikën A. Cakto koordinatat e pikës A duke e përdorur sistemin koordinativ.



Koordinatat e pikës A janë (__,__).

104. Cakto koordinatat e pikës A të dhëna në sistemin koordinativ në fotografi.




Koordinatat e pikës A janë (___, ___).

105. Në fotografi është dhënë plani i kinemasë ABC. Mentori e ka blerë biletën në rreshtin e gjashtë majtas, në ulësen 3.

Ngjyros (hijezo) ulësen e Mentorit.

	majtas								djathtas								
I	1	2	3	4	5	6	7	8	7	6	5	4	3	2	1	I	
II	1	2	3	4	5	6	7	8	7	6	5	4	3	2	1	II	
III	1	2	3	4	5	6	7	8	7	6	5	4	3	2	1	III	
IV	1	2	3	4	5	6	7	8	7	6	5	4	3	2	1	IV	
V	1	2	3	4	5	6	7	8	7	6	5	4	3	2	1	V	
VI	1	2	3	4	5	6	7	8	7	6	5	4	3	2	1	VI	
VII	1	2	3	4	5	6	7	8	7	6	5	4	3	2	1	VII	
VIII	1	2	3	4	5	6	7	8	7	6	5	4	3	2	1	VIII	
IX	1	2	3	4	5	6	7	8	7	6	5	4	3	2	1	IX	
X	1	2	3	4	5	6	7	8	7	6	5	4	3	2	1	X	
XI	1	2	3	4	5	6	7	8	7	6	5	4	3	2	1	XI	
XII	1	2	3	4	5	6	7	8	7	6	5	4	3	2	1	XII	

106. Në grafikon është dhënë të vizituarit e një web faqeje të internetit në mijëra. Në cilin muaj më së shumti, e në cilin më së paku e kanë vizituar vizitorët atë faqe?




Web faqen më së shumti e kanë vizituar në _____, kurse më së paku në _____.

107. Në grafikon është pasqyruar numri i ditëve me shi gjatë 6 muajve të parë të një viti.

a) Në cilët muaj ka pasur më shumë se 11 ditë me shi?

b) Në cilët muaj ka pasur më pak se 10 ditë me shi?



a) Më shumë se 11 ditë me shi kanë qenë në _____.

b) Më pak se 10 ditë me shi kanë qenë _____.

108. Në tabelë është pasqyruar orari i ngritjes së aeroplanëve nga aeroporti „Nikola Tesla“ dhe koha e uljes së aeroplanëve në destinacion sipas kohës së Beogradit.

Për cilin qytet zgjat fluturimi më së shumti?

Destinacioni	Koha e ngritjes së aeroplanëve	Koha e uljes së aeroplanëve
Beograd – Romë	6:40	8:40
Beograd – Vjenë	8:00	9:35
Beograd – Paris	9:00	12:15
Beograd – Londër	10:25	12:40
Beograd – Frankfurt	12:00	14:00

Fluturimi _____ është më i gjati.


109. Me tabelë janë pasqyruar notat mesatare nga matematika sipas paraleleve në fund të gjysmëvitit të parë. Lexo të dhënat në tabelë, e pastaj plotëso fjalitë nën tabelë.

Paralelja	Nota mesatare
VIII ₁	3,97
VIII ₂	4,01
VIII ₃	4,25
VIII ₄	3,78
VIII ₅	4,29
VIII ₆	3,88

Nota më e lartë mesatare është _____, dhe e ka fituar paralelja _____.

Nota më e ulët mesatare është _____, dhe e ka fituar paralelja _____.


110. Diagrami tregon ndryshimet në numrin e ditëve me diell gjatë vitit sipas muajve.



a) Më së paku ditë me diell në vit ka pasur në muajin _____.

b) Më së shumti ditë me diell në vit ka pasur në muajin _____.

111. Një grup i të të anketuarëve është përgjigjur në pyetjen sesi secili prej tyre e kalon kohën e lirë. Në bazë të grafikonit i cili i pasqyron përgjigjet e tyre plotëso tabelën përkatëse.




Aktiviteti	Numri i të të anketuarëve
Të lexuarit	
Interneti	
Filmat	
Sporti	
Aktivitetet tjera	


112. Arta dhe Artani e kanë bërë një anketim të vogël. I kanë lutur 75 shoqe dhe shokë të vet t'u përgjigjen në pyetjen: „Sa vëllezër dhe motra i keni?“. Rezultatet e kësaj ankete i kanë shënuar në tabelë (me zero janë shënuar ata të cilët nuk kanë as vëllezër as motra).

Numri i vëllezërve dhe i motrave	0	1	2	3	4
Shpeshtësia	18	39	14	3	1

Të dhënat nga tabela pasqyroji në grafikun sipas shembullit të dhënë



113. Me grafikun është pasqyruar sa luleshtrydhe ka mbledhur secili punëtor. Lexo të dhënat nga grafikoni dhe shënoji në tabelën e dhënë.




Punëtori	Sasia e luleshtrydheve në kg
Merita	
Arti	
Floriani	
Kaltrina	
Dritoni	
Drita	

114. Të pyetur cilin sport e do më së shumti në një shkollë janë fituar rezultatet të cilat janë pasqyruar me diagram rrethor.

Plotëso tabelën me të dhënat nga diagrami rrethor..


Sporti	Përqindja e nxënësve
	10%
	25%
	30%
	35%



115. Në tabelë është pasqyruar suksesi i nxënësve në hartim me shkrim.

Suksesi i nxënësve në hartim me shkrim	
Nota	Numri i nxënësve
5	3
4	6
3	12
2	7

Në bazë të të dhënave nga tabela përfundoje grafikun sipas shembullit të dhënë.




-
- 116.** Llogaria e muajit për ujë për familjen Bushati është 3 800 dinarë. Nga llogaria për ujë 2% ndahen për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Sa dinarë në muaj i ndan familja Bushati për mbrojtjen e mjedisit jetësor?
Familja Bushati për mbrojtjen e mjedisit jetësor i ndan _____ dinarë në muaj.
- 117.** Nga 40 detyra në test Majlinda saktësisht i ka zgjidhur 65% detyra. Sa detyra i ka zgjidhur saktësisht Majlinda?
Majlinda saktësisht i ka zgjidhur ____ detyra.
- 118.** Nga 80 dele në kope, 80% janë të bardha, kurse të gjitha të tjerat janë të zeza. Sa është numri i deleve të bardha në atë kope?
Numri i deleve të bardha në atë kope është _____.
- 119.** Nxënësit e klasës së VIII-të e festojnë ditën e maturës në diskotekën „Ylli“. Numri i nevojshëm i nxënësve për ta festuar maturën është 80% nga numri i përgjithshëm i nxënësve të asaj klase. Nëse në klasë janë 30, sa nxënës më së paku duhet të paraqiten për festim?
Për realizimin e festës duhet të paraqiten më së paku _____ nxënës.
- 120.** Majlinda ka vendosur të blejë atlete/patika të cilat kushtojnë 4 000 dinarë. Me rastin e blerjes shitësi ia ka lejuar zbritjen prej 10%. Sa është zbritja në dinarë?
Majlinda e ka fituar zbritjen _____ dinarë.

NIVELI I MESËM

Numrat dhe veprimet me ta

121. Në drejtëzën numerike janë dhënë pikat $A(0,75)$; $B(-\frac{3}{2})$; $C(\frac{1}{8})$; $D(\frac{5}{2})$; $E(-2,4)$; $F(-\frac{4}{5})$.

Në fushën e zbrazët shkruaj shkronjën përkatëse, sipas shembullit të dhënë.



122. Në fushë të zbrazët shënoje shenjën përkatëse = , > ose < ashtu që pohimi të jetë i saktë.

a) $-0,5$ $-\frac{2}{3}$

b) $-2\frac{1}{4}$ $2,25$

c) $\frac{1}{2}$ $0,33$

d) $0,2$ $\frac{1}{5}$

123. Rretho shkronjën para rendit në të cilin janë radhitur numrat nga më i vogli deri te më i madhi.

a) $\frac{1}{2}$; $0,2$; $-\frac{11}{10}$; $-\frac{5}{4}$

b) $-\frac{5}{4}$; $-\frac{11}{10}$; $\frac{1}{2}$; $0,2$

c) $-\frac{5}{4}$; $-\frac{11}{10}$; $0,2$; $\frac{1}{2}$

d) $\frac{1}{2}$; $0,2$; $-\frac{5}{4}$; $-\frac{11}{10}$

124. Janë dhënë thyesat $\frac{29}{50}$, $\frac{1}{2}$, $\frac{11}{20}$ dhe $\frac{49}{100}$.

Shëno një nga thyesat e dhëna ashtu që të fitosh mosbarazimin e saktë.

$0,54 < \underline{\hspace{2cm}} < 0,56$

125. Janë dhënë numrat

$$-\frac{1}{2} \quad 0,2 \quad -1,2 \quad 1\frac{1}{2}$$

Cili nga numrat e dhënë është më i madhi, e cili më i vogli?

Numri më i madh është _____, kurse numri më i vogël është _____.

126. Llogarit vlerën e shprehjes.

$$1,8 + 0,2 \cdot (2,25 - 1,2) =$$

127. Llogarit vlerën e shprehjes.

$$-3 + \left[\frac{1}{2} \cdot \frac{8}{3} - \left(-\frac{2}{3} : \frac{1}{6} \right) \right]$$

128. Është dhënë shprehja $A = -3 \cdot |2 - 7| + 5 \cdot |-2 + 3 + 4|$. Llogarit vlerën e shprehjes së dhënë A , e

pastaj llogarit $-A$, $\frac{1}{A}$, $|A|$.

129. Llogarit dhe shkruaj rezultatin përkatës.

a) $\left(\frac{3}{4} - \frac{1}{2} \right) \cdot 4 =$

b) $3,2 \cdot (4,3 + 5,7) =$

130. Plotëso tabelën e mëposhtme.

Numri x	$\frac{5}{2}$		$\frac{1}{5}$	
Vlera reciproke e numrit x	$\frac{2}{5}$			-1
Numri i kundërt me numrin x	$-\frac{5}{2}$	2		

131. Rretho numrin i cili është i pjesëtueshëm edhe me 2 edhe me 9.

12 301 230

5 053 545

816 372

29 944

132. Cilën shifër në numrin $\overline{128^*}$ mund ta vësh në vend të * që ta fitosh numrin katërshifror të pjesëtueshëm me numrin 9?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 1
- b) 2
- c) 5
- d) 7

133. Nga bashkësia {3428, 2145, 19, 760, 23, 222, 63} veço numrat të cilët janë:

- a) të pjesëtueshëm me 5
- b) të pjesëtueshëm me 3
- c) të pjesëtueshëm me 2
- d) të pjesëtueshëm me 9

134. Cili nga numrat e theksuar është i pjesëtueshëm edhe me 3 edhe me 5?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 1305
- b) 6500
- c) 4113
- d) 7113

135. Bashko numrat e dhënë me pohimin përkatës.

3030305 •

3030302 •

2020203 •

3050503 •

• Numri është i pjesëtueshëm me 3.

• Numri është i pjesëtueshëm me 2.

• Numri është i pjesëtueshëm me 5.

136. Në 100 g të përzierjes së çajit $\frac{2}{5}$ është mendër, $\frac{1}{4}$ është balsam, kurse pjesa tjetër është çaj kamomileje. Sa gramë kamomile janë në atë përzierje çaji?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 15 g
- b) 25 g
- c) 35 g
- d) 45 g

-
- 137.** Meritës prindërit i kanë dhënë para xhepi për muajin maj në shumën prej 2050 dinarësh. Çdo ditë gjatë atij muaji i ka harxhuar nga gjashtëdhjetë dinarë. Sa i kanë mbetur Meritës më 1 qershor nga parat e xhepit nga muaji maj?
Meritës i kanë mbetur _____ dinarë.
- 138.** Automobili e ka kaluar rrugën prej 360 km. Një të tretën e rrugës e ka kaluar me shpejtësi prej 60 km/h, kurse pjesën tjetër të mbetur të rrugës me shpejtësi prej 80 km/h. Për sa muaj automobili e ka kaluar tërë rrugën?
Automobili e ka kaluar rrugën për _____ h.
- 139.** Molekula e ujit përbëhet nga dy atome të hidrogjenit dhe një atomi të oksigjenit. Nëse masa relative e atomit të hidrogjenit është 1,0079 dhe masa relative e atomit të oksigjenit 15,999 sa është masa e përgjithshme relative e një molekule të ujit?
Masa e përgjithshme relative e një molekule të ujit është _____.
- 140.** Për 25 fletore janë paguar 750 dinarë. Fletorja 20 dinarë është më e shtrenjtë se lapsi. Për të njëjtën sasi të të hollave sa lapsa mund të blihen? Për 750 dinarë mund të blihen _____ lapsa.
Për 750 dinarë ka mundur të blihen _____ lapsa.

Algjebra dhe funksionet

141. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Zgjidhja e sistemit të barazimeve lineare

$$2x + 3y = 4$$

$$-3x + 2y = 7$$

është çifti i rregulluar i numrave:

a) $(-2, 3)$

b) $(2, 3)$

c) $(1, 2)$

d) $(-1, 2)$

142. Zgjidh barazimin.

$$\frac{3x+3}{3} = x - \frac{7x+2}{5}$$

143. Cili nga sistemet e ka zgjidhjen $(-1, -2)$?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

a) $x - 2y - 3 = 0$

$$y = x - 3$$

b) $2x - 2y - 3 = 0$

$$-x + 2y = 3$$

c) $x = -y - 3$

$$2y = x - 3$$

d) $x = 2y - 3$

$$y = x - 3$$

144. Zgjidh barazimin.

$$\frac{m+2}{2} - 1 = 0,5 - \frac{m+1}{4}$$

145. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Zgjidhja e barazimit $\frac{2x-3}{3} - \frac{5x-6}{6} = -2$ gjendet midis numrave:

a) -20 dhe -10

b) -10 dhe 10

c) 10 dhe 20

d) 20 dhe 30

146. Llogarit vlerën e shprehjes.

a) $2^3 - (0,5)^2 =$

b) $(5^2 - 3^3)^2 =$

c) $\sqrt{144} + 2\sqrt{81} - \sqrt{11^2} =$

147. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Vlera e shprehjes $\frac{2^{12} \cdot 4^3}{8^5}$ është:

a) 2^{10}

b) 2^9

c) 2

d) 2^3

148. Llogarit vlerën e shprehjes.

a) $3 \cdot \left(1 - \sqrt{\frac{4}{9}}\right) \cdot \sqrt{1\frac{9}{16}} =$

b) $\sqrt{1 - \frac{9}{25}} : \sqrt{0,36} =$

149. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Vlera e shprehjes $\frac{3 \cdot 9^2}{(-3)^4}$ është:

a) 9

b) 3

c) -3

d) -9

150. Nëse barazimi është i saktë rretho fjalën I SAKTË, e nëse nuk është i saktë rretho fjalën I PASAKTË.

$5^4 \cdot 5^3 = 5^{12}$	I SAKTË	I PASAKTË
$(2^3)^4 = (2^4)^3$	I SAKTË	I PASAKTË
$3^5 : 3^4 = 3$	I SAKTË	I PASAKTË
$\sqrt{9} + \sqrt{16} = \sqrt{9+16}$	I SAKTË	I PASAKTË

151. Rretho shkronjën para barazimit i cili është i saktë për secilin x .

- a) $(2x + 0,2)^2 = 2x^2 + 0,04$
- b) $(2x + 0,2)^2 = 4x^2 + 0,04$
- c) $(2x + 0,2)^2 = 4x^2 + 0,8x + 0,04$
- d) $(2x + 0,2)^2 = 4x^2 + 0,8x + 0,4$

152. Janë dhënë binomet $M = 3m - n$ dhe $N = 2m + 3n$. Thjeshtëso shprehjen.

- a) $M + N =$
- b) $M - N =$
- c) $M \cdot N =$

153. Rregullo polinomin i cili fitohet kur nga polinomi $9x^2 - 8x + 2$ zbritet katrori i binomit $3x + 1$.

Rezultati është _____.

154. Rretho PO nëse barazimi është i saktë ose JO nëse barazimi nuk është i saktë.

$(-2a + 3) \cdot (-5a + 3) = 10a^2 + 9$	PO	JO
$(2x - 3)^2 = 4x^2 - 12x + 9$	PO	JO
$(-2a + 3) \cdot (-3a + 2) = 6a^2 - 13a + 6$	PO	JO
$(2x + 3)^2 = 4x^2 + 9$	PO	JO

155. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Katrori i binomit $\frac{1}{2} m - n$ është:

- a) $\frac{1}{2} m^2 + 2mn + n^2$
- b) $\frac{1}{4} m^2 - mn + n^2$
- c) $\frac{1}{2} m^2 - mn + n^2$
- d) $\frac{1}{4} m^2 - n^2$

156. Arta përgatit ëmbëlsirë dhe nëse përdor katër vezë i nevojiten 280 gr sheqer. Nëse i përdor tri vezë, sa gramë sheqer i nevojiten asaj?

Për 3 vezë i nevojiten _____ g sheqer.

157. Numri i djelmoshave dhe i vajzave në shkollën “Naim Frashëri” është në përpjesëtim 7:8. Në këtë shkollë janë 480 vajza. Sa nxënës ka gjithsej kjo shkollë?

Në shkollën “Naim Frashëri” numri i përgjithshëm i nxënësve është _____.


158. Rretho shkronjën para funksionit i cili i përgjigjet grafikut:

a) $y = \frac{1}{3}x$


b) $y = \frac{1}{2}x$

c) $y = 2x$

d) $y = 3x$



159. Në njërin prej vizatimeve të dhëna grafikisht është pasqyruar vartësia midis sasisë së plumbit (x) dhe zinkut (y) në legurë, në të cilën plumbi dhe zinku janë përfaqësuar në raportin 2:1. Rretho shkronjën nën grafik në të cilin saktësisht është pasqyruar vartësia e plumbit dhe e zinkut në këtë legurë.



160. Për 8 m pëlhurë duhet të paguhen 2 400 dinarë.

a) Sa kushton 12 m të së njëjtës pëlhurë?

b) Sa metra të të njëjtit material mund të blihen për 750 dinarë?

a) 12 m pëlhurë kushtojnë _____ dinarë.

b) Për 750 dinarë mund të blihen _____ m pëlhurë.


161. Ledia në treg i ka paguar 5 kg luleshtrydhe dhe 2 kg qershi 300 dinarë. Luleshtrydhet i ka paguar 156 dinarë. Sa kushton një kilogram qershi?

Një kilogram qershi kushton _____ dinarë.

162. Aureli për çdo ditë i ndan nga 50 dinarë për biçikletë të re. Sa dinarë Aureli i ka tani nëse para tridhjetë ditësh e ka pasur të kursyer gjysmën e të hollave të veta që i ka tani?

Aureli tani i ka 3000 dinarë.

-
- 163.** Perimetri i trekëndëshit barabrinjës i cili është vizatuar në fotografi është 42 cm.
Sa është gjatësia e brinjës së trekëndëshit të vizatuar në fotografi?



Gjatësia e brinjës është _____ cm.


- 164.** Në dyqan me shumicë kanë qenë 1200 kg miell. Ditën e parë janë shitur 375 kg, ditën e dytë 105 kg më pak se ditën e parë. Në fund të ditës së tretë pas shitjes kanë mbetur 200 kg miell.
Sa kilogramë miell janë shitur ditën e tretë?
Ditën e tretë janë shitur _____ kilogramë miell.

- 165.** Kur Petriti e ka harxhuar një të tretën e kursimit të vet për të blerë mbushjen për celular, i kanë mbetur 800 dinarë. Sa ka kursyer Petriti?
Petriti i ka kursyer _____ dinarë.

Gjeometria

166. Llogarit masën e këndit bOc dhe masën e këndit bOd .

- a) Masa e këndit bOc është _____.
b) Masa e këndit bOd është _____.



167. Cilat nga dy këndet janë komplementare?


Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 23° dhe 37°
b) 23° dhe 67°
c) 23° dhe 77°
d) 23° dhe 157°


168. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Në trekëndëshin kënddrejtë ABC në fotografi, këndet e brendshme të kulmit A dhe B janë:


- a) suplementare (shtuese)
b) ndërruese
c) komplementare(plotësuese)
d) përgjegjëse (paralele)



169. Drejtëzat a dhe b në vizatim janë paralele. Cakto masat e këndeve α dhe β .



170. Cakto këndin α në fotografi.



$\alpha =$ _____

171. Cilat kënde mund të jenë kënde të brendshme të trekëndëshit?


Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) $50^\circ, 50^\circ, 50^\circ$
- b) $60^\circ, 60^\circ, 40^\circ$
- c) $40^\circ, 70^\circ, 70^\circ$
- d) $80^\circ, 80^\circ, 40^\circ$

172. Sa është këndi i jashtëm γ_1 i cili i përgjigjet kulmit C të katërkëndëshit $ABCD$ në fotografi?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.


- a) 51°
- b) 60°
- c) 61°
- d) 62°



173. Gjatësitë e brinjëve të trekëndëshit ABC në fotografi janë a , b dhe c . Cili mosbarazim është i saktë?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.


- a) $a < b < c$
- b) $b < a < c$
- c) $a < c < b$
- d) $b < c < a$



174. Diagonalet e rombit janë 10 cm dhe 24 cm.

Sa është perimetri i atij rombi?


Perimetri i rombit është ____ cm.




175. Sa është sipërfaqja e velës në fotografi?

Trego procedurën.

Sipërfaqja e velës është _____ m^2 .



- 176.** Në fotografi është dhënë një rrethqarkullim i detyruar. Sipërfaqja të cilën e zë tërë rrethqarkullimi i detyruar është $1225\pi \text{ m}^2$, kurse gjerësia e korsisë së lëvizjes është 10 m. Çfarë sipërfaqe zë hapësira e zbrazët në mesin e rrethqarkullimit të detyruar?



Sipërfaqja e hapësirës së zbrazët në mesin e rrethqarkullimit të detyruar është ____ m^2 .

- 177.** Perimetri i rrethit është $16\pi \text{ cm}$. Sa është sipërfaqja e tij?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.


- a) $256\pi \text{ cm}^2$
- b) $64\pi \text{ cm}^2$
- c) 256 cm^2
- d) 64 cm^2

- 178.** Diametri i rrotës së traktorit është 100 cm. Çfarë rruge do të kalojë traktori rrota e të cilit sillet pa rrëshqitje 7000 herë ($\pi \approx \frac{22}{7}$)?
Traktori do të kalojë ____ km.

- 179.** Perimetrat e harqeve të rrethëve koncentrikë janë $P_1 = 16\pi \text{ cm}$ dhe $P_2 = 10\pi \text{ cm}$. Sa është sipërfaqja e unazës përkatëse rrethore?

Sipërfaqja e unazës rrethore është ____ cm^2 .

- 180.** Sipërfaqja e rrethit më të vogël është $9\pi \text{ cm}^2$. Sipërfaqja e unazës është $16\pi \text{ cm}^2$.



Llogarit rrezën e rrethit më të madh.

Rrezja e rrethit më të madh është ____ cm.

- 181.** Llogarit sipërfaqen dhe vëllimin e sferës së rrezes 3 cm.

182. Rrezja e bazës së konit është 5 cm dhe lartësia e konit është 9 cm. Rrezja e bazës së konit tjetër është 10 cm dhe lartësia e konit është 3 cm. Nëse V_1 është vëllimi i konit të parë dhe V_2 vëllimi i konit të dytë cili pohim është i saktë?


Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) $V_1 < V_2$
- b) $V_1 = V_2$
- c) $V_1 > V_2$

183. Lartësia e konit $H = 6\sqrt{2}$ cm është e barabartë me rrezën e bazës. Sa është vëllimi i këtij koni?


Vëllimi i konit është _____ cm^3 .

184. Cili cilindër e ka sipërfaqen më të madhe?



Sipërfaqen më të madhe e ka cilindri ____.

185. Në fotografi 1 është cilindri vëllimi i të cilit është V_1 dhe në fotografi 2 është cilindri vëllimi i të cilit është V_2 . Cili pohim është i saktë?




Fotografia 1

Fotografia 2

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) $V_1 > V_2$
- b) $V_1 < V_2$
- c) $V_1 = V_2$

186. Në një fotografi drejtëza s është simetralja e segmentit AB . Cila është ajo fotografi?
Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.




187. Cili pohim është i saktë?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.


- a) Secili drejtkëndësh i ka më shumë se dy boshte të simetrisë në rrafsh.
- b) Trekëndëshi barabrinjës nuk ka bosht të simetrisë në rrafsh.
- c) Rrethi i ka saktësisht katër boshte të simetrisë në rrafsh.
- d) Katrori i ka katër boshte të simetrisë në rrafsh.

188. Rretho shkronjën mbi përgjigjen e saktë.


Cila nga figurat nuk e ka boshtin e simetrisë në rrafsh?



189. Rretho shkronjën para vizatimit në të cilin drejtëza s është boshti i simetrisë së drejkëndëshit?



190. Hijezo katër fusha në fotografi ashtu që të fitosh figurën simetrike me figurën e dhënë në krahasim me drejtëzën p .



Matjet

191. Cila kuti është më e lehtë?

Rretho shkronjën nën përgjigjen e saktë.



a)



b)



c)



d)

192. Rretho PO nëse mosbarazimi është i saktë ose JO nëse mosbarazimi nuk është i saktë.

$2,5 \text{ dm} > 2 \text{ m } 5 \text{ dm}$	PO	JO
$2 \text{ m} > 22 \text{ dm}$	PO	JO
$3 \text{ kg} < 300 \text{ g}$	PO	JO
$2 \text{ t} > 200 \text{ kg}$	PO	JO

193. Olta në orën e gjeografisë e ka marrë për detyrë të gjejë të dhënat për gjatësitë e pesë lumenjve më të gjatë të cilët rrjedhin nëpër Serbi. Të dhënat i ka kërkuar në Internet, në libër shkollor dhe në enciklopedi, i ka shënuar dhe e ka kuptuar se gjatësitë e lumenjve janë dhënë në njësi të ndryshme matëse.

Morava Jugore (295 km)

Morava Perëndimore (308 000 m)

Timoku (202 km)

Morava e Madhe (185 km)

Ibri (2 720 000 dm)

Cili nga këta pesë lumenj është më i shkurti, e cili më i gjati?


Lumi më i shkurtër është _____, kurse më i gjatë është _____.

194. Arsimitarja në tabelë e ka shkruar masën e katër objekteve.

Rretho shkronjën para objektit i cili e ka masën më të madhe.



a)



b)



c)



d)

195. Shitësi i ka në dyqan tri pula të pastruara masat e të cilave peshojnë 1340 g, 1,35 kg dhe 1 kg 290 g.

Radhit këto masa sipas madhësisë, nga më e madhja deri te më e vogla.

_____ > _____ > _____

196. Alulja dëshiron që përmes internetit të blejë një libër i cili kushton 52,99 dollarë. Libraria virtuale e bën të mundur pagimin në euro ashtu që një 1 dollar vlen 0,75 euro. Me cilin përpjesëtim do ta shndërrojë Alulja çmimin në dollarë të librit në çmimin në euro?

Rretho përgjigjen e saktë.

a) $0,75 : 52,99 = x : 1$

b) $1 : 52,99 = 0,75 : x$

c) $1 : x = 52,99 : 0,75$

d) $x : 52,99 = 1 : 0,75$

197. Naimi shkon në ekskursion në Vjenë. Rruga dhe qëndrimi i kushtojnë 300 euro dhe i paguan në gjashtë këste të barabarta. Çfarë shume duhet të paguajë Naimi në dinarë për këstin e parë, nëse në ditën e pagimit një euro e ka pasur vlerën 107 dinarë?

Naimi për këstin e parë duhet të paguajë _____ dinarë.

198. Për 100 dollarë mund të blehesh 72 euro. Sa euro mund të blehesh për 75 dollarë?

Për 75 dollarë mund të blehesh _____ euro.

199. Majlinda festat e Vitit të Ri i ka kaluar në Itali. Rruga dhe qëndrimi kushtojnë 200 euro. Çfarë shume ka paguar Majlinda, në dinarë, nëse ditën e pagimit 1 euro e ka pasur vlerën 105 dinarë?

Majlinda i ka paguar _____ dinarë.

200. Nëse një krunë norvegjeze vlen 12,50 dinarë, kurse një euro 105 dinarë, sa vlejnjë 10 euro në kruna norvegjeze?

10 euro vlejnjë _____ kruna norvegjeze.

201. Rina përgatit lazanje. Për mbushje duhet të peshojë një të tretën e kremit të qumështit. Përafërsisht sa mililitra të kremit të qumështit i nevojiten?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

a) 300 ml

b) 310 ml

c) 320 ml

d) 330 ml

202. Rretho me PO nëse përgjigjja është e saktë ose JO nëse përgjigjja nuk është e saktë.

Me numrin 109,2 numër i plotë më i afërt është 110.	PO	JO
Me numrin 3,4556 numër më i afërt me një numër dhjetor është numri 3,5.	PO	JO
Me numrin 499,4 numër i plotë më i afërt është 500.	PO	JO

203. Me cilin numër të plotë është përafërsisht e barabartë thyesa $\frac{2103}{7}$?


Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 301
- b) 300
- c) 31
- d) 30

204. Rrumbullakos në dy numra dhjetorë këta numra:

- a) 3,845739
- b) 0,663455
- c) 1,632057
- d) 2,017386

205. Luleshitësi duhet të rrumbullakos çmimin e luleve nga importi në numrin më të afërt të plotë. Shkruaj çmimet e reja.




Bima	A	B	C
Çmimi i ri			

Përpunimi i të dhënave


206. Cakto koordinatat e pikës B e cila është qendrore simetrike e pikës $A (-3,5)$ në krahasim me pozicionin fillestar koordinues.

B (____, ____)


207. Cakto koordinatat e pikës B simetrike me pikën A në krahasim me drejtëzën a .




208. Në bazë të koordinatave të dhëna të pikës A vizato në sistemin koordinativ pikën $M (-1,2)$.




209. Në sistemin koordinativ xOy shëno pikat E, F dhe G kështu e fiton vijën e hapur të thyer $ABCDEFGE$ e cila është simetrike në krahasim me boshtin y .



210. Në bazë të koordinatave të dhëna të pikës A vizato boshtin y të drejtkëndëshit të Sistemit koordinant të Dekartit.



211. Në grafikon është dhënë koha në minuta të cilën e ka kaluar Roni duke mësuar matematikë. Gjatë javës Roni sa mesatarisht ka mësuar matematikë në ditë?



Roni mesatarisht i ka kaluar në ditë _____ minuta duke mësuar matematikë.

- 212.** Aureli i ka 8 disqe me numra muzikorë. Në secilin disk e ka shënuar kohëzgjatjen. Cili disk e ka kohëzgjatjen më të afërt me gjatësinë mesatare të kohëzgjatjes së disqeve?

Disku nr.	Gjatësia në minuta
Disku 1	81
Disku 2	84
Disku 3	76
Disku 4	78
Disku 5	82
Disku 6	86
Disku 7	72
Disku 8	73

Disku numër ___ e ka kohëzgjatjen më të afërt me gjatësinë mesatare të kohëzgjatjes së disqeve.

- 213.** Në tabelë është dhënë numri i mesazheve SMS të cilat i kanë dërguar gjatë ekskursionit nxënësit e katër paraleleve të klasës së tetë të një shkolle.

Paralelja	Numri i nxënësve të cilët kanë shkuar në ekskursion	Numri i mesazheve SMS të dërguara
VIII ₁	28	455
VIII ₂	30	518
VIII ₃	24	331
VIII ₄	29	592

Sa është numri mesatar i mesazheve të dërguara, sipas paraleles?

Numri mesatar i mesazheve të dërguara për paralele është _____.

- 214.** Arti ka punuar pesë ditë në një projekt nga informatika. Në tabelë sipas ditëve është pasqyruar sa orë Arti i ka kaluar pranë kompjuterit gjatë ditës. Llogarit numrin mesatar të orëve të cilat i ka kaluar Arti në ditë gjatë këtyre pesë ditëve në kompjuter.

Dita	Numri i orëve në kompjuter
E hënë	1,5
E martë	2
E mërkurë	3,5
E enjte	3
E premte	5

Mesatarisht gjatë këtyre 5 ditëve i ka kaluar _____ orë në kompjuter.

- 215.** Është dhënë tabela e cila i paraqet largësitë reciproke të qyteteve të shprehura në kilometra. Në bazë të tabelës plotëso këto fjali ashtu që pohimi të jetë i saktë.

Beograd							
Çaçak	144						
Kragujevc	120	87					
Nikshiq	536	395	482				
Nish	239	186	143	576			
Novi Sad	81	225	219	616	314		
Zrenjanin	80	224	200	616	319	50	
	Beograd	Çaçak	Kragujevc	Nikshiq	Nish	Novi Sad	Zrenjanin

- a) Largësia midis Çaçakut dhe Nikshiqit është _____ kilometra.
b) Largësia midis Nikshiqit dhe _____ është e njëjtë si edhe largësia midis Nikshiqit dhe _____ .

- 216.** Emina i ka ushtruar detyrat për provimin e maturës. Numrin e detyrave të zgjidhura e ka shënuar sipas mënyrës së pasqyruar në fotografi. Të shtunën ka mësuar statistikë dhe ka vendosur të llogaritë medianën për të dhënat e grumbulluara.

Sa është mediana për të dhënat e grumbulluara.

E hënë: ### ### ||

E martë: ### |||

E mërkurë: ### ### |||

E enjte: |||

E premte: ### ### |

E shtunë: ### ### ### ||

Mediana për të dhënat e grumbulluara është _____.

- 217.** Lartësitë e anëtareve të ekipit të volejbollit për femra të një shkolle, dhënë në centimetra, janë: 169, 170, 165, 172, 168, 173, 176, 180, 170, 167, 164, 174.

Plotëso tabelën në bazë të të dhënave të dhëna.

Lartësia	Numri i anëtareve
Më e ulët se 165 cm	
165 cm – 168 cm	
169 cm – 172 cm	
173 cm – 175 cm	
175 cm – 178 cm	
Më e lartë se 178 cm	

218. Nxënësit të pyetur: „Sa orë në ditë e shikoni TV?“ me radhë janë përgjigjur: 2 orë, 2,5 orë, 3 orë, 1 orë, 1,5 orë, 2 orë, 1 orë, 2,5 orë, 4 orë, 3 orë, 1 orë, 0,5 orë. Plotëso tabelën në bazë të dhënave të grumbulluara.

Numri i orëve (h)	$h \leq 1$ orë	$1 \text{ orë} < h \leq 2$ orë	$2 \text{ orë} < h \leq 3$ orë	$h > 3$ orë
Numri i nxënësve				


219. Në tabelë janë pasqyruar të dhënat për numrin e fëmijëve të cilët kanë qëndruar në Këndin e lojërave „Kolibri“ gjatë një jave.

Dita	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E diel
Numri i fëmijëve	72	54	64	78	147	251	194

Sa është mediana për të dhënat e grumbulluara?

Mediana është _____.

220. Suksesi i nxënësve të një paraleleje në testin e matematikës është pasqyruar me diagram.



a) Plotëso, sipas shembullit të dhënë, tabelën e cila i përgjigjet diagramit të dhënë:

Suksesi i nxënësve në testin e matematikës	
Nota	Numri i nxënësve
5	
4	
3	
2	
1	3

b) Llogarit notën mesatare në testin e matematikës.

Nota mesatare në testin e matematikës është _____.

NIVELI I PËRPARUAR

Numrat dhe veprimet me ta

- 221.** Cakto numrin më të vogël pesëshifror të gjitha shifrat e të cilit janë të ndryshme dhe i cili është i pjesëtueshëm me numrin 6.
Ky numër është _____.
- 222.** Cakto numrin më të madh katërshifror të pjesëtueshëm me numrin 18.
Ky numër është _____.
- 223.** Grupi i ushtarëve, të cilët janë më shumë se 180 dhe më pak se 200, është nisur në marsh të rreshtimit në kolona të barabarta nga katër ushtarë, kurse janë kthyer nga marshi në kolona të barabarta nga gjashtë ushtarë. Sa ushtarë gjithsej kanë qenë në atë marsh?
Gjithsej kanë qenë _____ ushtarë.
- 224.** Cakto numrin më të madh treshifror të pjesëtueshëm me 12.
Ky numër është _____.
- 225.** Shkruaj tre numra të pesëmijëshes shifra e dhjetësheve e të cilës është 2, e të cilët janë të pjesëtueshëm me 9.
Këta janë numrat _____, _____, _____.
- 226.** Në rezervuar të automobilit janë 60 litra benzinë dhe me ta mund të kalohen 600 kilometra. Llamba në tabelën e kontrollit fillon të ndizet kur në rezervuar mbeten më pak se $\frac{1}{20}$ e sasisë së benzinës. Sapo që ka filluar llamba të ndizet janë hedhur në rezervuar edhe 9 l benzinë. Edhe sa kilometra mund të kalojmë derisa rezervuari plotësisht nuk zbrazet?
Mund të kalojmë _____ kilometra.
- 227.** Petriti në provim ka pasur 3 herë më shumë përgjigje të sakta nga ato të pasakta. Nëse në provim kanë qenë 20 detyra, sa detyra i ka zgjidhur saktësisht?
Petriti i ka zgjidhur saktësisht _____ detyra.
- 228.** Një banesë dydhomëshe e ka sipërfaqen e kuzhinës dy herë më të vogël se sa sipërfaqja e trapezarisë, sipërfaqen e korridorit tri herë më të vogël se sa sipërfaqja e dhomës së gjumit, sipërfaqen e dhomës së ditës pesë herë më të madhe se sa sipërfaqja e korridorit, sipërfaqen e banjës dy herë më të vogël se sa sipërfaqja e dhomës së gjumit dhe dy dhoma të gjumit të njëjta me sipërfaqe nga $11,4 \text{ m}^2$. Sipërfaqja e trapezarisë është për $2,1 \text{ m}^2$ më e vogël se sa sipërfaqja e dhomës së gjumit. Sa është sipërfaqja e tërë banesës?
Sipërfaqja e përgjithshme e banesës është _____ m^2 .

229. Familja Shkoza harxhon $\frac{2}{3}$ e të të ardhurave të veta për banesë dhe për ushqim, $\frac{1}{8}$ për veshmbathje dhe pjesën e mbetur për nevojat tjera. Për veshmbathje Shkozajt harxhojnë në muaj 12 000 dinarë. Sa të holla familja Shkoza i harxhon për nevojat tjera?
Për nevojat tjera familja i harxhon _____ dinarë.

230. Buqetet të cilat i bën luleshitësja, i kanë nga 4 trëndafila dhe 5 luleshqerre. Nëse luleshitësja për secilin trëndafil i fiton 35 dinarë, për secilën luleshqerre të shitur i fiton 25 dinarë dhe për përgatitjen e buqetit 60 dinarë, sa buqete më së paku duhet të shesë për të fituar më shumë se 1500 dinarë?
Luleshitësja duhet të shesë më së paku _____ buqete.

Algjebra dhe funksionet

231. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Vlera e shprehjes $\frac{5\sqrt{2} - \sqrt{32} + 4\sqrt{50}}{7\sqrt{2}}$ është:

- a) 1
- b) 2
- c) 3
- d) 4

232. Thjeshtëso shprehjen $\left(\frac{x^2 \cdot x^4 \cdot x^5}{x \cdot x^3}\right)^2 : x^{10}$, e pastaj llogarit vlerën e saj për $x = \sqrt{(-5)^2}$.

233. Llogarit vlerën e shprehjes.

$$3\sqrt{\frac{4}{9}} - \sqrt{(-6)^2} \cdot \sqrt{0,36} - 2$$

Vlera e shprehjes është _____.

234. Llogarit vlerën e shprehjes.

$$\left(1\frac{1}{2}\right)^7 \cdot \left(1\frac{1}{3}\right)^7 : 2^7 - (\sqrt{80} - 2 - 4\sqrt{5})$$

Vlera e shprehjes është _____.

235. Nëse dihet se $32^2 = 1024$, llogarit:

- a) $\sqrt{10,24} =$ _____
- b) $\sqrt{102400} =$ _____
- c) $\sqrt{0,1024} =$ _____

236. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Nëse $a + b = 5$ dhe $a \cdot b = \frac{1}{4}$ atëherë $a^2 + b^2$:

- a) 25
- b) 10
- c) $24\frac{1}{2}$
- d) $25\frac{1}{2}$

237. Thjeshtëso shprehjen.

$$(a+3)^2 - (-2a+1)(a+2) + 2a(1-4a)$$

238. Thjeshtëso shprehjen e cila fitohet kur katrori i shumës së monomit $2x$ dhe $5y$ zvogëlohet për shumën e katrorit të monomit $3x$ dhe $4y$.

239. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Polinomi $(a-1)(2a+1) - (a-6)(a+6)$ është i barabartë me polinomin:

a) $a^2 - a + 35$

b) $a^2 - a - 37$

c) $a^2 + 35$

d) $a^2 - 37$

240. Llogarit dhe shkruaj rezultatin përkatës.

a) ndryshimin e katrorit të numrave 7 dhe 3: _____

b) katrorin e ndryshimit të numrave 7 dhe 3: _____

c) shumën e katrorit të numrave 7 dhe 3: _____

d) katrorin e shumës së numrave 7 dhe 3: _____

241. Cakto funksionin linear $y = kx + n$ nëse grafiku i tij është paralel me grafikun e funksionit $y = -\frac{3}{2}x + 99$ dhe përmban pikën $A(-4, 8)$.

Funksioni është _____

242. Gardhin rreth shkollës 5 nxënës do ta ngjyrosnin për 10 ditë. Pas 2 ditësh u janë bashkuar edhe 3 shokë. Për sa ditë do të kryhet tërë puna?

Ngjyrosjen e gardhit nxënësit do ta përfundojë për _____ ditë.

243. Automobili kalon rrugën për 1,75 h duke shkuar me shpejtësi prej 60 km/h. Me cilën shpejtësi duhet të shkojë ai automobil për të kaluar të njëjtën rrugë për 1,5 h?


Automobili duhet të shkojë me shpejtësi prej _____ km/h.

244. Nëntë shokë do të pastronin pishinën për katër ditë. Edhe sa shokë duhet t'u ndihmojnë që të pastrojnë pishinën për tri ditë?

Pishina do të pastrohet për tri ditë nëse u ndihmojnë edhe _____ shokë.

245. Cili nga grafikët përfaqëson grafikun e funksionit $y = -x + 3$?

Rretho shkronjën mbi përgjigjen e saktë.



246. Mentori për tri video lojëra dhe dy filma i ka paguar 6200 dinarë. Nëse filmi është 6 herë më i lirë se sa lojëra, sa kushton lojëra, sa kushton lojëra, e sa filmi?

Lojëra kushton _____ dinarë, filmi kushton _____ dinarë.

247. Një grup i nxënësve të klasës së tretë niset në marsh ekologjik duke i bërë 80 hapa në minutë, secili hap e ka gjatësinë 60 cm. Grupi i dytë i nxënësve të klasës së gjashtë niset me ta 9 minuta më vonë duke i bërë 100 hapa me gjatësi 75 cm. Për sa minuta do t'i bashkohet grupi i dytë grupit të parë.

Grupi i dytë i nxënësve do t'i bashkohet grupit të parë për _____ minuta.

248. Në autobus në linjën „Qendra“ gjenden 52 udhëtarë. Në stacion „Te ura“ disa udhëtarë kanë dalë nga autobusi, kurse katër kanë hyrë në të. Në stacionin e ardhshëm nga stacioni ka dalë një e treta e udhëtarëve të cilët deri më atëherë kanë qenë në të, kurse kanë hyrë tre udhëtarë. Tani në autobus janë 25 udhëtarë. Sa udhëtarë kanë dalë nga autobusi në stacionin „Te ura“? Në stacionin „Te ura“ nga autobusi kanë dalë _____ udhëtarë.

249. Nëse $2x - y = 4$ dhe $x + \frac{y}{2} = 1$, atëherë vlera e shprehjes $4x^2 + y^2$ është e barabartë:

- a) 8
- b) 10
- c) 9
- d) 19

250. Derisa ka qenë në verim, Nora secilit prej 9 miqve të vet nga ndërtesa i është lajmëruar ose me letër ose me kartolinë. Pullat postare për letra i ka paguar nga 10 dinarë kure pullat postare për kartolina nga 15 dinarë. Sa letra dhe sa kartolina i ka dërguar Nora nëse për pulla postare gjithsej i ka paguar 110 dinarë?


Tregoje procedurën.

Nora i ka dërguar _____ letra dhe _____ kartolina.


Gjeometria

251. Llogarit këndin α nëse drejtëzat a dhe b në fotografi janë normale.

$\alpha =$ _____




252. Simetralja s e këndit të brendshëm të kulmi A e trekëndëshit kënddrejtë ABC e ndërton me kateten e kundërt këndin prej 65° . Llogarit këndin e brendshëm të kulmi A dhe këndin e brendshëm të kulmi B të këtij trekëndëshi ABC .



Këndi i brendshëm të kulmi A është _____ dhe i brendshëm të kulmi B është _____.

253. Nëse $a \parallel b$, llogarit këndet α dhe β .




$\alpha =$ _____ dhe $\beta =$ _____


254. Në trekëndëshin ABC janë të njohur këndi i brendshëm $\beta = 25^\circ 15'$ dhe këndi i jashtëm $\alpha_1 = 60^\circ 15'$. Llogarit këndin e brendshëm γ .

$\gamma =$ _____

255. Nëse drejtëzat a dhe b janë paralele, cakto sa është këndi α .




256. Llogarit perimetrin e katërkëndëshit $ABCD$ në fotografi..




$P =$ _____ cm

257. Figura në fotografi është përbërë nga pesë katrorë që janë përgjegjës. Nëse $MN = 10$ cm, llogarit sipërfaqen e kësaj figure..



Sipërfaqja e figurës është _____ cm^2 .


258. Diagonalet e trapezit barabrinjës priten nën këndin e drejtë. Nëse gjatësitë e bazave të trapezit janë 12 cm dhe 4 cm, llogarit sipërfaqen e trapezit.



Sipërfaqja e trapezit është _____ cm^2 .


259. Llogarit perimetrin e trekëndëshit ABC , nëse lartësia e cila i përgjigjet brinjës AB është e barabartë 5 cm, këndi i brendshëm te kulmi A është 45° dhe këndi i brendshëm te kulmi B është 30° .

260. Sa metra tel nevojiten për t'u rrethuar oborri në formë të trapezit drejtkëndësh si në figurë?




Nevojiten _____ m tel.

261. Në fotografi është harku rrethor i rrezes së dhënë dhe i këndit qendror. Sa është gjatësia e rrezes së rrethit perimetri i të cilit është i barabartë me gjatësinë e atij harku l ?




Gjatësia e rrezes së atij rrethi është _____ cm.

262. Në fotografi është tetëkëndëshi i rregullt i brendashkruar në rreth. Llogarit këndin β .




263. Llogarit gjatësinë e vijës së lakuar në fotografi.



Gjatësia e vijës së lakuar është _____ cm.

264. Nëse gjatësia e kordës AB është e barabartë me rrezën e rrethit, llogarit masën e këndit ACB .



Masa e këndit ACB është _____.

265. Sa herë është sipërfaqja e prerjes rrethore, këndi qendror i së cilës është 30° , më e vogël se sipërfaqja e rrethit?


Është më e vogël _____ herë.

266. Skënderi dëshiron që t'i dhurojë Petritit një top për të cilën i nevojitet një kuti përkatëse. Perimetri i rrethit të madh të topit është 125,6 cm. Në dyqan ka kuti në formë të kubit. Zgjedhe kutinë me vëllim më të vogël në të cilën do të hyjë topi.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) kutia me tehun 50 cm
- b) kutia me tehun 40 cm
- c) kutia me tehun 30 cm
- d) kutia me tehun 20 cm

267. Piramida e rregullt katërfaqëshe e ka vëllimin $V = 36\sqrt{2}$ cm³. Trekëndëshi SAC është drejtkëndësh barabrinjës. Llogarit gjatësinë e bazës së tehut të piramidës..




Gjatësia e tehut të bazës është _____ cm.

- 268.** Sipërfaqja e prizmit të rregullt trefaqësh është $S = 56\sqrt{3}$ cm², kurse tehu bazë 8 cm. Sa është lartësia e këtij prizmi?
Lartësia e këtij prizmi është ___ cm.


- 269.** Një teh i kuboidit është 7 cm, kurse përpjestimi i dy teheve të tjera është 3 : 5. Sa është sipërfaqja e kuboidit nëse vëllimi i tij është 420 cm³?
Sipërfaqja e kuboidit është ___ cm².

- 270.** Llogarit vëllimin e piramidës së rregullt katërfaqëshe nëse tehu i bazës është $a = 10$ cm, kurse lartësia e brinjës anësore $h = 13$ cm.
Trego procedurën.




Vëllimi i piramidës është _____ cm³.

- 271.** Përftorja e konit sipërfaqja e bazës së cilit është 108π cm² me rrezën e bazës e ndërton këndin prej 30°. Sa herë është vëllimi i këtij koni më i madh se sa vëllimi i sferës së rrezes 3 cm?



Vëllimi i konit është ___ herë më i madh se sa vëllimi i sferës.

- 272.** Gjysmërrethi, rrezja e të cilit është 18 cm, është i lakuar në mbështjellësin e konit. Sa është vëllimi i konit?



Vëllimi i konit është _____ cm³.


273. Ëmbëlsira është përgatitur në formë të sferës e cila i ka dy shtresa. Shtresa e brendshme është nga marcipani dhe e ka rrezen 3 cm, dhe rreth saj një shtresë çokollate me trashësi 3 cm. Sa është vëllimi i pjesës së ëmbëlsirës nga çokollata në këtë ëmbëlsirë?
Vëllimi i pjesës së ëmbëlsirës nga çokollata në këtë ëmbëlsirë është ____ cm^3 .

274. Trekëndëshi kënddrejtë, katetet e të cilit janë $a = 9 \text{ cm}$, $b = 12 \text{ cm}$, sillet rreth katetes b . Sa është raporti midis sipërfaqes së bazës dhe sipërfaqes së mbështjellësit të fituar të konit?
Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 1 : 1
- b) 3 : 4
- c) 3 : 5
- d) 4 : 5


275. Sa është sipërfaqja e sferës më të madhe e cila mund të qëndrojë në një kuti me formë të kubit me faqen 20 cm?
Sipërfaqja e sferës është ____ cm^2 .

276. Nga trekëndëshi kënddrejtë ABC është prerë trekëndëshi kënddrejtë $A_1B_1C_1$ me ç'rast BC është paralelisht me B_1C_1 . Nëse $AC = 12 \text{ cm}$, $BC = 5 \text{ cm}$ dhe $A_1B_1 = 3,25 \text{ cm}$, sa është sipërfaqja e pjesës së hijezuar të trekëndëshit ABC ?



Sipërfaqja e pjesës së hijezuar të trekëndëshit në fotografi është ____ cm^2 .

277. Në fotografi është $AC \parallel ED$. Llogarit gjatësinë e segmentit EB .



$EB =$ ____ cm .


278. Perimetri i trekëndëshit barabrinjës është 40 cm. Brinja e trekëndëshit është për 2 cm më e gjatë se baza. Llogarit perimetrin e trekëndëshit të ngjashëm me të brinja e të cilit është 18 cm.

Perimetri i këtij trekëndëshi është ____ cm.

279. Segmenti MN është paralel me segmentin AB . Nëse $MN : AB = 2 : 3$, sa është përpjesëtimi $CM : MA$?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 2 : 1
- b) 3 : 1
- c) 3 : 2
- d) 2 : 3



280. Te pohimi i saktë rrethoje fjalën I saktë, kurse te pohimi i pasaktë fjalën I pasaktë.

Çdo dy trekëndësha barabrinjës janë të ngjashëm ndërveti.	I saktë	I pasaktë
Çdo dy trekëndësha të ngjashëm i kanë perimetrat e barabartë.	I saktë	I pasaktë
Dy trekëndësha barabrinjës me kënd mbi maje prej 36° janë trekëndësha të ngjashëm.	I saktë	I pasaktë
Të gjithë trekëndëshat kënddrejtë reciprokisht janë të ngjashëm.	I saktë	I pasaktë

Matjet

281. Arti në dyqan e ka vënë në shportë nga një qese me secilin nga artikujt çmimet e të cilëve janë dhënë në fotografi. Ai deri te arka e ka llogaritur sa duhet të paguajë duke e rrumbullakuar çmimin e secilit artikulli në dinarë të plotë. Në arkë e ka marrë llogarinë të cilën arkëtari ia ka rrumbullakuar në numër të plotë në dinarë. Për sa dinarë dallohen llogaritjet e tyre?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 0 dinar
- b) 1 dinar
- c) 2 dinarë
- d) 3 dinarë

Bajame.....	58,52 dinarë
Lajthi	63,89 dinarë
Lulediell....	22,02 dinarë
Arra.....	45,90 dinarë
Kikirik	40,55 dinarë
Susamë.....	40,51 dinarë

282. Mirandi e ka ndërtuar pishinën me gjatësi 10,1 m, gjerësi 7,9 m dhe thellësi 2,8 m. Tri të katërtat e pishinës i ka mbushur me ujë. Çmimi i një metri kub të ujit është 31,03 dinarë . Pa kalkulator duke e rrumbullakësuar secilën të dhënë të duhur e ka llogaritur sa dinarë i duhen për të paguar një mbushje me ujë të pishinës. Cila nga këto vlera të dhëna është vlera më e afërt me vlerësimin të cilin Mirandi ka mundur ta llogaritë?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 3 400 dinarë
- b) 4 400 dinarë
- c) 5 400 dinarë
- d) 6 400 dinarë

283. Rrezoni, Mentori Endoni dhe Floriani e kanë matur gjatësinë e bankës së shkollës dhe rezultatet e fituara i kanë shënuar në tabelë.

Nxënësi	Gjatësia e matur e bankës
Rrezoni	1,315 m
Mentori	128 cm
Endoni	13,3 dm
Floriani	1309 mm




Nëse është gjatësia e bankës së shkollës saktësisht 1,3 metra, cili prej këtyre katër nxënësve e ka bërë gabimin në matje më të vogël se një centimetër?

Gabimin në matje më të vogël se një centimetër e ka bërë _____.

284. Mimoza nga operatori i rrjetit të celularëve e ka marrë porosinë me të cilën është njohtuar se në muajin korrik i ka dërguar 192 porosi dhe që ka biseduar 48 minuta. Mimoza e di se çmimi i një porosie është 2,85 dinarë dhe që çmimi i një minute bisedë është 7,12 dinarë. Në këto çmime është përfshirë edhe tatimi për vlerën e shtuar. Mimoza ka dashur që pa kalkulator të llogarisë sa do të jetë llogaria e saj për muajin korrik. Ajo i ka rrumbullakësuar çmimet në numrin më të afërt të plotë të dinarit, kurse numrin e mesazheve dhe të minutave e ka rrumbullakësuar në dhjetëshen më të afërt. Në këtë mënyrë sa e ka llogaritur Mimoza se duhet të paguajë llogarinë për muajin korrik?

Mimoza në këtë mënyrë e ka llogaritur se do të paguajë _____dinarë.

285. Largësia midis vendit A dhe vendit D është pasqyruar në hartën e mëposhtme.



Merita e ka vlerësuar largësinë midis vendit A dhe vendit D kështu që e ka rrumbullakësuar secilën nga largësitë në numrin më të përafërt të plotë të kilometrave dhe i ka mbledhur. Vjosa i ka mbledhur largësitë e shënuara në hartë, dhe rezultatin e fituar e ka rrumbullakuar me numrin më të afërt të plotë të kilometrave.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.


- a) Merita e ka fituar numrin më të madh se sa Vjosa.
- b) Merita dhe Vjosa i kanë fituar numrat e barabartë.
- c) Merita e ka fituar numrin më të vogël se sa Vjosa.

Përpunimi i të dhënave

286. Cakto koordinatat e pikës A e cila u takon grafikëve të funksioneve $y = 3x + 3$ dhe $-2x - 2 - y = 0$.


$A(\underline{\quad}, \underline{\quad})$

287. Në fotografi janë dhënë pikat $A(6, 2)$ dhe $B(2, 6)$. Pika S është pika qendrore e segmentit AB . Sa është pika qendrore e segmentit BS larg nga pozicioni i fillimit koordinativ?




Pika qendrore e segmentit BS larg nga pozicioni i fillimit koordinativ $\underline{\quad}$.

288. Vizato të gjitha pikat në sistemin koordinativ vlerat absolute të koordinatave të të cilave janë dy herë më të mëdha se sa vlera absolute e koordinatave të pikës së dhënë.




289. Brinja e rombit $ABCD$ e ka gjatësinë e pesë segmenteve të njëjve. Nëse AC është diagonalja më e gjatë e këtij rombi, cakto koordinatat e pikave B dhe D , kështu që katërkëndëshi i fituar të jetë rombi $ABCD$



B (____, ____)


D (____, ____)

290. Vizato në sistemin koordinativ të gjitha pikat të cilat janë në të njëjtën largësi nga boshti x si edhe pika A , e të cilat e kanë largësinë nga boshti y dy herë më të madhe sesa largësia e pikës A nga boshti y .



291. Tre kamionë, K_1 , K_2 dhe K_3 , të cilët e transportojnë ndihmën humanitare, janë nisur në kohë të ndryshme. Grafikoni i qarkullimit të tyre është pasqyruar në kohën prej orës 10 deri në orën 12 h.


- Cili kamion është nisur para orës 10 h?
- Cili kamion ka qarkulluar më së shpejti?



- Kamioni ____ është nisur para orës 10 h.
- Më së shpejti ka qarkulluar kamioni ____.


292. Biciklisti Jetoni e ka ngarë biçikletën nga vendi A deri në vendin B dhe është kthyer prapa. Një orë pas tij, nga vendi A në drejtim të vendit B, është nisur nisur edhe Arti. Diagrami në fotografi e tregon largësinë e biciklistit nga vendi A varësisht nga koha.

- Nëse Jetoni është nisur në orën 8:00, në sa ora ka arritur në vendin B?
- Nëse ora Arti e ka takuar Jetonin?
- Sa kilometra ka kaluar Jetoni derisa është takuar me Artin?




- Jetoni ka arritur në vendin B në orën ____ e ____ minuta.
- Arti e ka takuar Jetonin në orën ____ e ____ minuta.
- Jetoni i ka kaluar ____ kilometra derisa është takuar me Artin.

293. Ndryshimi i sasisë së lëndës djegëse në rezervuar gjatë rrugës është pasqyruar me grafikun. Sa gjithsej litra të lëndës djegëse janë hedhur në rezervuar gjatë rrugës?



Në rezervuar janë hedhur _____ litra lëndë djegëse.

294. Numri i nxënësve të klasës së VIII të cilët e vijojnë një nga seksionet, është pasqyruar me diagramet e dhëna.



Paralelja	VIII ₁	VIII ₂	VIII ₃	VIII ₄
Numri i nxënësve në paralele	32	36	35	27

Cila paralele e ka numrin më të madh të nxënësve të cilat nuk i vijojnë seksionet?

Paralelja _____.

295. Në tabelë janë dhënë largësitë e disa qyteteve në kilometra.

	Beogradi	Kragujevci	Nishi	Novi Sadi	Pazari i Ri	Subotica	Zajeqari
Beogradi		115	239	82	271	178	236
Jagodina	165	42	104	217	196	319	117
Kragujevci	115	–	146	197	160	299	159
Kraleva	192	54	152	251	106	353	193
Krushevc	192	70	91	274	167	376	132


- a) Cili qytet është larg nga Beogradi 115 km? _____
- b) Cilat dy qytete janë larg 353 km? _____
- c) Cilat dy qytete janë larg më së paku 50 km? _____
- d) Sa qytete në tabelë janë larg nga Beogradi më shumë se 200 km? _____

296. Tabela e dhënë tregon çmimet për emitimin e spotit në televizion „JM“ varësisht nga gjatësia e kohëzgjatjes dhe numri i emitimit të një spoti. Televizioni „JM“ lejon edhe secilin kombinim nga më së paku 5 emitime. Firma „Natalia“ dëshiron që spoti i tyre të emitohej dy herë nga 10 sekonda, pesë herë nga 20 sekonda dhe një herë 30 sekonda. Sa kushton një paketë e tillë?

Gjatësia e spotit	Numri i emitimeve ditore	Vlera e paketës
10 sekonda	5	18 000,00
20 sekonda	5	36 000,00
10 sekonda	10	36 000,00
20 sekonda	10	69 000,00
30 sekonda	5	54 000,00
30 sekonda	10	109 000,00

Vlera e paketës për firmën „Natalia“ është _____ dinarë.


- 297.** Petriti është nisur nga shtëpia në orën 8. Dy orët e para ka ecur me shpejtësi prej 4,5 km/h. Pastaj ka pushuar 1,5 h. Më vonë është kthyer i pushuar duke ecur me shpejtësi prej 6 km/h.



- Paraqit të ecurit e Petritit në grafik.
- Në sa ora është kthyer Petriti në shtëpi?

- 298.** Furra e bukës „Qerimi” ka prodhuar në janar 2 tonë bukë. Në shkurt prodhimi është shtuar për 500 kilogramë. Në mars dhe në prill prodhimi ka mbetur në nivel të njëjtë si në shkurt, në maj prodhimi i bukës është shtuar për një tonë, kurse në qershor, korrik dhe në gusht ka rënë për 500 kilogramë. Në shtator prodhimi është shtuar për 500 kilogramë, kurse në tetor për një ton.

- Përfundo diagramin e filluar i cili e tregon prodhimin e bukës në furrën „Qerimi”.
- Sa tonë bukë i ka prodhuar furra e bukës „Qerimi” në tetor?
- Në cilët muaj prodhimi i bukës ka qenë nën 2,5 tonë?




- Furra e bukës „Qerimi” në tetor i ka prodhuar _____ tonë bukë.
- Prodhimi i bukës ka qenë nën 2,5 tonë në _____.


299. Në një shkollë njëqind nxënës e kanë dhënë provimin nga matematika. Pas testit përfaqësuesit e parlamentit të nxënësve e kanë organizuar anketën dhe i kanë lutur ata të cilët e kanë dhënë provimin të vlerësojnë vështirësinë e testit. Rezultatet e anketës janë pasqyruar në tabelë.

Vlerësimi i vështirësisë së testit	i thjeshtë	mesatar	i ndërlikuar	pa përgjigje
Numri i të të anketuarëve	7	18	50	25

Paraqit këto të dhëna në diagramin rrethor, sipas shembullit të dhënë.



300. Rina i ka ngarë rolerët 45 minuta. Në 10 minutat e parë të ngarjes së rolerëve e ka arritur shpejtësinë prej 10km/h. Me këtë shpejtësi ka qarkulluar gjatë 20 minutave të ardhshëm, e pastaj ka filluar njësoj të ngadalësojë derisa nuk është ndalur. Plotëso diagramin i cili e tregon lëvizjen e Rinës, sipas shembullit të dhënë.



301. Sipërfaqja e një drejtkëndëshi është S . Nëse brinja e tij a zmadhohet për 20%, kurse brinja b zvogëlohet për 20% fitohet drejtkëndëshi me sipërfaqe S_1 . Vetëm një nga përgjigjet e dhëna është e saktë.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) $S_1 = S$
- b) $S_1 = 4\% S$
- c) $S_1 > S$
- d) $S_1 = 96\% S$


-
- 302.** Gjatë javës së parë të majit në supermarket janë shitur 880 kuti me biskota. Javën e ardhshme janë shitur 15% më pak kuti me biskota. Sa është numri i përgjithshëm i kutive të shitura me biskotë gjatë dy javëve të para të muajit maj?
Numri i përgjithshëm i kutive të shitura me biskotë është_____.
- 303.** Çmimi i kompjuterit është shtuar për 4% për shkak të ndryshimit të kursit të dinarit. Administrata e kompanisë „Rim tak“ e ka marrë vendimin që me rastin e pagimit me para në dorë të lejojë uljen e çmimeve prej 10%, gjë që është 4 212 dinarë. Sa ka qenë çmimi i kompjuterit para ndryshimit të kursit të dinarit?
Çmimi i kompjuterit ka qenë _____ dinarë.
- 304.** Fatjoni i ka investuar 30 000 dinarë në bankën ABM. Kamata vjetore është 10% dhe llogaritet në fund të vitit. Sa dinarë do të ketë Fatjoni në llogari pas dy vjetësh, me kusht që të mos i ketë marrë të hollat nga llogaria gjatë kësaj kohe?
Fatjoni i ka në llogari _____ dinarë.
- 305.** Çmimi i librit së pari është shtuar për 10%, e pastaj është zvogëluar për 10% dhe tani është 198 dinarë. Sa ka qenë çmimi i librit para shtrenjtimit?
Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.
- a) 198 dinarë
 - b) 200 dinarë
 - c) 202 dinarë
 - d) 196,02 dinarë

Shembujt për pjesën e testit në provimin e fundit të cilat do t'i anketojnë detyrat e reja të pabotuara

306. Sa është sipërfaqja e prizmit të rregullt trëfaqësh tehu bazë i të cilit e ka gjatësinë 4 cm dhe lartësinë e prizmit 2 cm?


Sipërfaqja e prizmit është _____ cm².

307. Sa është vëllimi i piramidës gjashtëfaqëshe tehu bazë i të cilës është 3 cm dhe lartësia e piramidës $3\sqrt{3}$ cm?




Vëllimi i piramidës është _____ cm³.

308. Sa është sipërfaqja e piramidës së rregullt barabrinjëse katërfaqëshe tehu i së cilës është $a = 6$ cm?



Sipërfaqja e piramidës është _____ cm².

309. Tehu i kubit është 2 cm. Sa është sipërfaqja e kuboidit i cili është bërë nga dy kube të tillë?



Sipërfaqja e kuboidit është _____ cm²

310. Tehu i piramidës së rregullt trëfaqëshe barabrinjëse është 8 cm. Sa është sipërfaqja e saj? Sipërfaqja e piramidës është _____ cm².

- 311.** Në dyqan gjatë fundjavës bëhet zbritja prej 15% për secilën llogari e cila është më e madhe se 3 500 dinarë. Nëse Merita të premten i ka harxhuar 4 260 dinarë, sa do të kursente sikur të kishte blerë të shtunën?
Merita do të kursente _____ dinarë.
- 312.** Për blerjen më shumë se 20 ekzemplarëve të një reviste lejohet zbritja prej 12%. Shkolla ka vendosur të blejë 25 ekzemplarë të asaj reviste. Sa do të paguajë shkolla revistat nëse një ekzemplar i revistës kushton 200 dinarë?
Shkolla do të paguajë revistat _____ dinarë.
- 313.** Për garën komunale nga matematika janë paraqitur 48 nxënës nga 200 pjesëmarrës në garën shkollore. Sa është përqindja e nxënësve të cilët janë paraqitur për garën komunale?
Për garën komunale nga matematika janë paraqitur _____% e nxënësve.
- 314.** Marrja me qira e apartamentit për verim kushton 630 euro. Nëse tërë shuma paguhet deri më 1 mars, realizohet ulja e çmimit për 20%. Sa është çmimi me ulje të çmimit?
Çmimi me ulje është _____ euro.
- 315.** Vjosa shet akullore. Për secilën akullore të shitur me çmimin prej 60 dinarësh, ajo i fiton 6 dinarë. Sa është fitimi i saj për një akullore i shprehur në përqindje?
Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.
- a) 6 %
b) 1 %
c) 54 %
d) 10 %

316. Llogarit $A : B$ nëse $A = \left(\frac{1}{4} - 1\right) : \left(\frac{1}{8} - 1\right)$ dhe $B = \left(\frac{1}{3} + 1\right) : \left(\frac{1}{6} + 1\right)$.

317. Llogarit vlerën e shprehjes.
 $(-0,7 + 0,3 \cdot 4 - 1 : 0,5) : (-0,1) + 1,1 =$

318. Llogarit vlerën e shprehjes.

$$-4\frac{1}{2} - \left(\frac{2}{5} - \left(\frac{3}{5} - \frac{1}{5} : \left(\frac{4}{5} - 1\right)\right)\right) =$$

319. Nëse $A = \left(-4\frac{1}{4} : (-0,85) - \frac{1}{2}\right) : \left((-5,56 + 4,06) \cdot \left(-\frac{1}{3}\right)\right)$ dhe $B = 6 - 6 \cdot \left(\frac{1}{2} + \frac{1}{3}\right)$

sa është $\frac{A+B}{2}$?

320. Llogarit prodhimin e shprehjes A dhe B , nëse $A = 1 + 3 : \frac{6}{5} - \frac{2}{5} \cdot \frac{5}{4}$ dhe $B = \frac{8}{3} - \frac{7}{3} \cdot \frac{6}{7}$.
 $A =$ _____, $B =$ _____, $A \cdot B =$ _____

321. Për cilat vlera x ndryshimi i shprehjes $(2x + 1)^2$ dhe $(2x - 1) \cdot (2x + 1)$ është jonegativ?
 Për x _____ ndryshimi i shprehjeve të dhëna është jonegativ.

322. Shuma e dy numrave është 28, kurse $\frac{1}{3}$ e numrit të parë është e barabartë me $\frac{1}{4}$ e numrit të dytë. Cilët janë ata numra?

Numri i parë është _____, numri i dytë është _____.

